

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
Arkiv: Qendror - Centralno Arkivo - Central Archive

Nr./Br./No. 3073  
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 4/4/4  
Data/Datum/Date: 13.08.2024  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.15/2024<sup>1</sup> PËR  
NDARYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV  
NR.09/2008 PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË AKUAKULTURËS**

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.15/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.09/2008 për licencimin e aktiviteteve të akuakulturës, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

Në mbështetje të nenit 8 (paragrafi 1.4), nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.15/2024 PËR NDRYSHIMIN DHE  
PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.09/2008 PËR LICENCIMIN E  
AKTIVITETEVE TË AKUAKULTURËS**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.09/2008 për Licencimin e Aktiviteteve të kulturës me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që i përcaktojnë dhënien e lejeve dhe licencave dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike pas kryerjes së inspektimeve.

**Neni 2**

Neni 2 i Udhëzimit Administrativ bazik fjalja Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural zëvendësohet me fjalinë Agjencia për Ushqim dhe Veterinari.

**Neni 3**

Neni 5 paragrafi 5.2 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

5.2. në sistemin elektronik krijohet kërkesa elektronike e cila përmban të gjitha elementet sipas Shtojcës 1 të Udhëzimit Administrativ bazik dhe ka vlerën e njëjtë si kërkesa fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes këtij sistemi.

**Neni 4**

Neni 7 paragrafi 7.1 pika (a) të Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

(a) dy (2) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe një (1) përfaqësues nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

**Neni 5**

Neni 8 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1. Në sistemin elektronik krijohet forma e licencës sipas Shtojcës 2 të Udhëzimit Administrativ bazik.

#### **Neni 6**

Neni 9 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1. Forma e licencës duhet të përmbajë tekstin si në vazhdim:
  - 1.1. Emrin dhe logon e autoritetit licencues;
  - 1.2. Numrin dhe emërtimin e licencës;
  - 1.3. Të dhënat e personit të licencuar;
  - 1.4. Numri i biznesit;
  - 1.5. Sipërfaqja e hurdhës në ha;
  - 1.6. Lloji i peshqve apo organizmave tjerë urojë që mbarështohen;
  - 1.7. Leja për shfrytëzimin e ujit - sasia e ujit;
  - 1.8. Leja për shkarkimin e ujit.
2. Nënshkrimi bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

#### **Neni 7**

Neni 10 paragrafi 10.1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 8**

Neni 11 paragrafi 11.1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 8**

Neni 12 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

#### **Neni 10**

Neni 13 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

#### **Neni 11**

Në nenin 14 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

## Neni 12

Në neni 15 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministri” zëvendësohet me fjalën “Drejtori Ekzekutiv”.

## Neni 13

Neni 20 paragrafi 20.1 dhe paragrafi 20.3 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

## Neni 14 Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Faton PEÇI**  
  
13 / 108 / 2024

